

UDHËZUES

MBI PUNËN EDUKATIVO-ARSIMORE NË PARALELET E KOMBINUARA NË ARSIMIN FILLOR



Министерство за образование и наука
Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science
Bureau for Development of Education

UDHËZUES

MBI PUNËN EDUKATIVO-ARSIMORE
NË PARALELET E KOMBINUARA
NË ARSIMIN FILLOR

Udhëzues mbi punën edukative-arsimore në paralelet e kombinuara në arsimin fillor

Botues:

Byroja për Zhvillim të Arsimit

Autorë:

Ajshe Ajrulai, Liljana Samarxhiska-Panova, Eizabeta Tomevska-Ilievaska, Lulzim Mehmedi, Danica Talimxhioska, Vançe Manevski

Përkthimi në gjuhën shqipe:

ABAKUS

Dizajni

Brigada dizajn

Shtypi:

Data Pons

CIP - Katalogizimi i publikimit
Biblioteka Nationale dhe Universitare "Shën. Klimenti i Ohrit", Shkup

373.3.043.2(497.7)(083.131)

UDHËZUES mbi punën edukative-arsimore në paralelet e kombinuara në arsimin fillor / [Ajshe Ajrullai ... etj.]. - Shkup: Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2020. - 56 f. : tabela; 24 cm

Fusnota konteksti. - Autorë të tjerë: Liljana Samarxhiska-Panova, Elizabeta Tomevska-Ilievaska, Lulzim Mehmedi, Danica Talimxhioska, Vançe Manevski. - Biografia: f. 38. - Përmbajtja dhe: Shtojca 1-4

ISBN 978-608-206-049-1

1. Ajrullai, Ajshe [autore] 2. Samarxhiska-Panova, Liljana [autore] 3. Tomevska-Ilievaska, Elizabeta [autore] 4. Mehmedi, Lulzim [autor] 5. Talimxhioska, Danica [autore] 6. Manevski, Vançe [autor]

a) Arsimi fillor - Paralelet e kombinuara - Organizimi i mësimdhënies - Maqedonia - Udhëzime

COBISS.MK-ID 51521797



Përpilimi i këtij dokumenti dhe përkthimi në shqip, turqisht serbisht dhe gjuhën boshnjake është mundësuar me mbështetjet financiare nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk i shpreh qendrimet dhe pikëpamjet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja:

HYRJA	05
1. PARALELET E KOMBINUARA NË ARSIMIN FILLOR	07
1.1. Përkufizimi i nocionit paralele të kombinuara	07
1.2. Përparësitë dhe sfidat e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara	08
1.2.1. Përparësitë e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara	08
1.2.2. Sfidat e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara	11
2. ROLI I UDHËHEQJES SË SHKOLLËS NË ORGANIZIMIN E MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA	12
2.1. Përzgjedhja e arsimtarëve	12
2.2. Formimi i paraleles së kombinuar	13
3. ORGANIZIMI I HAPËSIRËS/KLASËS NË PARALELEN E KOMBINUAR	14
4. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA	17
4.1. Llojet e planifikimit në paralelen e kombinuar	17
4.1.1. Planifikimi vjetor	18
4.1.2. Planifikimi afatmesëm/tematik	20
4.1.3. Planifikimi ditor/ Planifikimi i orës së mësimi	23
5. ORGANIZIMI I MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA	26
5.1. Forma organizative të punës në paralelet e kombinuara	26
5.2. Strategjitë didaktike për punë në grupe të vogla nxënësish me mosha të ndryshme zhvillimore	27
5.3. Llojet e orëve mësimore në paralelet e kombinuara	32
5.4. Organizimi i orës sipas orarit të lëndëve mësimore	33
5.5. Orari i orëve të mësimi në paralelet e kombinuara	35
5.6. Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni në paralelet e kombinuara	37
LITERATURA	38
SHTOJCA	39



Hyrja

Udhëzuesi mbi punën edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara në arsimin fillor është material ndihmës, përkatësisht mbështetje profesionale për arsimtarët të cilët realizojnë mësimdhënie në paralele të kombinuara.

Në shtetin tonë ekziston një numër i madh paralelesh të kombinuara. Sipas të dhënave të Byrosë për Zhvillim të Arsimit, në vitin shkollor 2018/2019 ka pasur 911 paralele të kombinuara gjithsej (844 paralele të kombinuara me nxënës nga klasa e parë deri në klasën e pestë dhe 67 paralele të kombinuara me nxënës nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë). Të dhëna më konkrete mbi numrin e paraleleve të kombinuara janë dhënë në shtojcën në këtë udhëzues (Tabela 1, Tabela 2, Tabela 3 dhe Shtojca 3).

Formimi i paraleleve të kombinuara bazohet në Ligjin për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161 datë 05.08.2019). Sipas nenit 53, paragrafët 8 dhe 9 të Ligjit për arsimin fillor (8), në shkollën nëntëvjeçare mund të formohet një paralele e kombinuar, sipas rregullit, nga nxënësit e klasës së parë deri në të tretën, me nxënës të klasës së katërt dhe të pestë ose me nxënës nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, pas marrjes së miratimit nga themeluesi. (9) Themeluesi mund të formojë një paralele të kombinuar pasi të marrë mendim pozitiv nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në teorinë tonë pedagogjike, është shkruar shumë mbi punën edukativo-arsimore me paralele të kombinuara, kurse kjo problematikë nuk është trajtuar sa duhet në fakultetet që i edukojnë arsimtarët e ardhshëm. Sidoqoftë, një numër i madh arsimtarësh e fillojnë angazhimin e tyre profesional në paralele të kombinuara, nga kjo rrjedh edhe nevoja për të përgatitur këtë udhëzues.

Qëllimet e këtij udhëzuesi janë:

- Të jetë mbështetje profesionale për stafin udhëheqës në shkolla gjatë përzgjedhjes së arsimtarëve, gjatë formimit të paraleleve të kombinuara, organizimit të mësimdhënies etj,;
- T’u japë drejtime arsimtarëve në procesin e planifikimit të mësimdhënies (plani vjetor, plani afatmesëm dhe plani ditor, përkatësisht plani i orës së mësimdhënies);
- Të jetë mbështetje profesionale për arsimtarët gjatë përzgjedhjes së formave të organizimit, metodave të mësimdhënies, teknikave dhe aktiviteteve që t’i zhvillojnë dhe/ose përforcojnë kompetencat e veta profesionale gjatë punës në paralele të kombinuara;



- T'u japë drejtime arsimtarëve për organizim efikas të hapësirës dhe kohës dhe për krijim të mjedisit stimulues për mësim në paralele të kombinuara.

Ky udhëzues jep mundësi mbi shfrytëzimin e aspekteve të ndryshme në organizimin dhe realizimin e mësimdhënies në paralele të kombinuara dhe i prezanton anët pozitive, si dhe sfidat e mësimdhënies në paralele të kombinuara në arsimin fillor.



1. PARALELET E KOMBINUARA NË ARSIMIN FILLOR

Në shtetin tonë paralele të kombinuara më shpesh ka në vendet e banuara rurale dhe më rrallë në ato urbane, përkatësisht aty ku numri i nxënësve të regjistruar është i vogël. Nga ana tjetër, për shkak të infrastrukturës së keqe rrugore deri në shkollat më të largëta ekziston rreziku që nxënësit e moshave më të vogla të mos e përfundojnë arsimin fillor, prandaj organizohen paralele të kombinuara.

Formimi i paraleleve të kombinuara nuk rrjedh nga mungesa e arsimtarëve në sistem, apo nga pamundësia për të rekrutuar arsimtarë të rinj, por është strategji se si të sigurohet arsimi në të gjitha mjediset ku ka nxënës.

1.1. Përkufizimi i nocionit paralele të kombinuara

Paralele të kombinuara janë ato paralele në të cilat janë përfshirë nxënës nga dy apo më tepër klasa të periudhës së parë zhvillimore të arsimit dhe edukimit themelor, dy ose më shumë klasa nga periudha e dytë zhvillimore, si edhe dy ose më shumë klasa nga periudha e tretë zhvillimore e arsimit dhe edukimit themelor. Me përjashtim, në shkollat ku ka një numër më të vogël nxënësish, paralele e kombinuar është edhe paralelja e formuar nga bashkimi i pesë klasave të para. Paralelet e kombinuara në literaturën pedagogjike quhen edhe “paralele të bashkuara”, sepse përfaqësojnë një bashkësi heterogjene nxënësish të grupmoshave të ndryshme (dallimi nga një deri në tri vjet), ku mësimdhënien e realizon një arsimtar.



1.2. Përparësitë dhe sfidat e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara

Sipas Dajan Latail Demor (Diane Lataille-Dmor), profesoreshë në Universitetin Laurentian¹, e cila e studion këtë problematikë, nxënësit në paralelet e kombinuara arrijnë të njëjtin nivel të rezultateve si edhe nxënësit në paralelet me një klasë. Këto rezultate janë të tilla falë bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërmjetme që ekziston në këto mjedise. Nxënësit kanë interaksion të vazhdueshëm me bashkënxënësit e vet të moshave të ndryshme dhe të shkallëve të ndryshme të zhvillimit, kurse mësimi kooperativ, mundësia për interaksion të shpeshtë, si dhe integrimi i lëndëve mësimore e përkrahin mësimin efikas. Në studimin ku morën pjesë 50 arsimtarë nga Ontario, Kanada, është konkluduar se të mësuarit kooperativ, mentorimi dhe integrimi i lëndëve arsimore janë strategji relevante dhe efikase për punën me paralele të kombinuara.

Nxënësit e paraleleve të kombinuara, në krahasim me nxënësit e paraleleve klasike, kanë qëndrim pozitiv ndaj shkollës, shkathtësi më të mëdha të liderizmit, vetërespektim, përshtatje më të lehtë sociale dhe sjellje më pak agresive.²

1.2.1. Përparësitë e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara

Paralelet e kombinuara nuk paraqesin një lloj të mësimdhënies të organizuar vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por organizohen edhe në shtete të tjera evropiane, si edhe në Amerikën Latine, Kanada, Azi, Afrikë, Australi etj. Organizimi i një lloji të tillë të punës edukative-arsimore është i rëndësishëm për shumë arsye:

- Përfaqëson formë përkatëse për edukimin dhe arsimin e obligueshëm për të gjithë;

¹ Lataille-Démoré, D. (2005). Guide documenté des pratiques réussies. Projet des classes à niveaux multiples. CD-ROM. Ontario Ministry of Education. 21. Veenman, S., Kenter, B. et Post.

² Parvin Kadivar, Shokooh Navabi Nejad, and Zahra Madadi Emamzade, Effectiveness of Multi-Grade Classes: Cooperative Learning as a Key Element of Success, gjendet në këtë vegëzë: <https://pdfs.semanticscholar.org/d776/46fc5f444e1c058d79d31890cf795d45fedc.pdf>



- Siguron edukim dhe arsim cilësor për fëmijët të cilët mund të anashkalo-
hen për shkak se jetojnë në mjedise të vogla dhe të largëta;
- Siguron edukim dhe arsim cilësor për çdo nxënës në vendin ku ai jeton;
- Paraqet mundësi të mirë që nxënësit të mësojnë nga njëri-tjetri;
- Mundëson zhvillim të interaksionit më pozitiv midis nxënësve, duke
mundësuar kështu mbështetje në zhvillimin social-emocional të nx-
ënësve;
- Mundëson mësim bashkëpunues dhe të pavarur dhe në bashkëpunim për
nxënësit.

Çdo periudhë trevjeçare në edukimin dhe arsimin fillor përbën një tërësi relativisht të përfunduar, si në raport me karakteristikat zhvillimore të nxënësve dhe shprehive për të mësuar, ashtu edhe sipas mënyrë së ndjekjes, kontrollimit dhe vlerësimit të njohurive të nxënësve dhe shkathtësive të zhvilluara dhe qëndrimeve të përvetësuar nga nxënësit. Periudhat arsimore përputhen me nivelet zhvillimore të zhvillimit kognitiv dhe social-emocional të fëmijës. Në paralelet e kombinuara në një periudhë më të shkurtër mund të realizohen përmbajtjet e planifikuara në nivele të ndryshme: nxënësit e moshës më të vogël mund të njihen me nocionet e reja, të përsëritin dhe të vërtetojnë atë që e kanë mësuar, kurse nxënësit e moshës më të madhe ta zgjerojnë dhe thellojnë nivelin e njohurive. Arsimitarët të cilët një periudhë të gjatë kanë punuar me paralele të kombinuara theksojnë një sërë përparësish të mësimdhënies së kombinar:

- Ekzistojnë shumë mundësi më të mëdha që nxënësit të punojnë dhe të zhvillohen vazhdimisht në përputhje me mundësitë e veta individuale.
- Fleksibiliteti i grupimit në punën e këtyre paraleleve e tejkalon formimin e zakonshëm të grupeve sipas aftësive, karakteristike për një moshë zhvillimore, si dhe mundëson të dalin në pah aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve të cilat janë më të mëdha ose më të vogla se ato që priten në një moshë të caktuar.
- Në paralelet e kombinuara arsimtari i kushton një pjesë të madhe të kohës punës së pavarur të nxënësve. Nëpërmjet punës së pavarur, nxënësit i identifikojnë, thellojnë, përvetësojnë dhe zbatojnë njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë e reja në mënyrë të organizuar dhe të planifikuar, me ndihmë profesionale-pedagogjike dhe në bashkëpunim me arsimtarin. Hulumtimet dëshmojnë se nxënësit të cilët deri në klasën e pestë kanë



vijuar paralele të kombinuar, pas përfshirjes në klasat më të larta tregojnë shkallë më të lartë të pavarësisë dhe zhdërvjelltësisë.

- Nxënësit më të mëdhenj i dëgjojnë dhe i ndjekin sërish ato që arsimtari ua mëson dhe shpjegon nxënësve të moshës më të vogël, kurse kjo kontribuon që të plotësohet dhe përforcohet ajo që e kanë mësuar, dhe çon drejt të mësuarit më cilësor.
- Nxënësit e moshës më të vogël i dëgjojnë bisedat e arsimtarit me nxënësit më të mëdhenj, kurse kjo i motivon dhe i nxit që të mendojnë.
- Zvogëlohet konkurrenca kognitive, fizike dhe sociale midis moshatarëve, si dhe ankthi për shkak të shpirtit garues. Në paralelet e kombinuara atmosfera e punës ndikon mbi bashkëpunimin dhe nuk përbën garë. Nuk nevojiten masa shtesë për të mbajtur disiplinën në paralele.
- Nxënësit në moshë më të vogël e hetojnë sjelljen, pritshmëritë dhe vlerat e përvetësuara te nxënësit e moshës më të madhe. Arsimtari luan rolin kryesor në modelimin dhe organizimin e të mësuarit në lidhje me shkathhtësitë sociale, kurse në paralelet e kombinuara nxënësit më të vegjël mund të shikojnë edhe modele të tjera të sjelljes dhe në mënyrë spontane të praktikojnë shkathhtësitë sociale.
- Nxënësit më të mëdhenj kanë mundësi që me të vërtetë t'i ndihmojnë nxënësit më të vegjël gjatë të mësuarit. Kur u shpjegojnë nxënësve në moshë më të vogël, ata i kontrollojnë edhe dijet dhe njohuritë e veta. Në këtë mënyrë përmirësohen zhvillimi kognitiv dhe vetërespektimi i nxënësve në moshë më të madhe dhe më të vogël. Në paralelet me nxënës të të njëjtës moshë kjo gjë ndodh shumë rrallë.
- Paralelet e kombinuara janë më pak homogjene se paralelet me nxënës të të njëjtës moshë, kështu që në to pranohen më lehtë të gjitha dallimet midis nxënësve.
- Në paralelet e kombinuara të gjithë nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në kohë të ndryshme, kështu që te ta, me kalimin e kohës, zmadhohet edhe vetëdisiplina dhe përgjegjësia.
- Nxënësit mësojnë më shpejt se si të mësojnë.
- Me kalimin e kohës, në paralelet e kombinuara përforcohen besimi, mirëkuptimi, pritjet dhe marrëdhëniet pozitive midis arsimtarit dhe nxënësve, si dhe midis arsimtarit dhe prindërve.



- NËPËRMJET PËRVOJËS PROFESIONALE NË MËSIMIN E NXËNËSVE NË PARALELET E KOMBINUARA, ARSIMITARI I MBBINDËRTON VAZHDIMISHT NJOHURITË E VETA NË LIDHJE ME INTERESAT, MUNDËSITË DHE NEVOJAT E ÇDO NXËNËSI. Ndonjëherë nevojitet më tepër se një vit shkollor që të zbulohet se në cilën mënyrë mëson më mirë një nxënës i caktuar.
- Nxënësit marrin shumë përvoja, komunikojnë me nxënësit e moshave të ndryshme dhe përvetësojnë disa shkathtësi të nevojshme jetësore.
- Nxënësit në paralelet e kombinuara fitojnë siguri të madhe emocionale, sidomos ata që kanë mbështetje më të vogël në suazat e familjeve të tyre.
- Nxënësit me interesa dhe mundësi më të mëdha dhe nxënësit me nevojat të veçanta arsimore do të përfshihen më lehtë në punën në grupe ku punohet me detyra më të komplikuara, përkatësisht më të lehta.
- Numri i vogël i nxënësve në paralelet e kombinuara e lehtëson procesin e ndjekjes dhe vlerësimit të arritjeve të çdo nxënësi.

1.2.2.Sfidat e punës edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara

Puna edukative-arsimore në paralelet e kombinuara imponon edhe një numër të caktuar sfidash:

- Punë me shumë klasa njëkohësisht në një klasë.
- Përgatitje të materialeve mësimore për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha klasat.
- Kushtim i vëmendjes nxënësve të cilët mësojnë ngadalë.
- Ndjekje e vazhdueshme e aktiviteteve dhe e detyrave në paralele.
- I kushtohet vëmendje më e madhe vlerësimit.
- I kushtohet vëmendje më e madhe shpërndarjes së aktiviteteve dhe vlerësimit të mirë të arritjeve të nxënësve.
- Nevojë për mbështetje më të shpeshtë nga personat profesionistë dhe institucionet relevante/kompetente edukuesarsimore.
- Dokumentim dhe evidencë e madhe pedagogjike.



2. ROLI I UDHËHEQJES SË SHKOLLËS NË ORGANIZIMIN E MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA

2.1. Përzgjedhja e arsimtarëve

Arsimtari i cili do të punojë në klasa të kombinuara, përveç kompetencave të përcaktuara për një arsimtar, duhet të ketë edhe karakteristika të tjera, siç janë shkathtësia, fleksibiliteti, ekspeditiviteti, konstruktiviteti, krijimtaria, etj., që të jetë në gjendje të përshtatë orarin dhe planifikimin e mësimdhënies me kushtet në paralele, t'i njohë karakteristikat zhvillimore të nxënësve, të punojë aktivisht në mënyrë të barabartë në mbështetje të niveleve dhe aspekteve të ndryshme të zhvillimit të nxënësve (kognitiv, social-emocional, afektiv, etj.), për të menaxhuar mirë procesin e mësimdhënies dhe orët e mësimit.

Për këto arsye duhet të bëhet përzgjedhje e kujdesshme e arsimtarëve (kur ekziston kjo mundësi) të cilët do të punojnë në paralele të kombinuara. Dihet se mësimdhënia në paralele të kombinuara është një proces shumë specifik, për të cilin arsimtarët në arsimimin e tyre inicial janë trajnuar shumë pak, kështu që njohuritë dhe shkathtësitë për këtë lloj pune i marrin drejtpërdrejt në praktikë. Nga kjo rrjedh nevoja që në shkollat ku mësimdhënia nuk mbahet vetëm në paralele të kombinuara, gjatë përzgjedhjes së arsimtarit në paralele të kombinuara t'i jepet përparësi arsimtarit më me përvojë ose arsimtarit i cili mban paralele që kanë arritjet më të mira me nxënësit.

Arsimtari duhet të ketë të zhvilluar aftësinë për ndarjen e të rëndësishmes nga e parëndësishmja, aftësinë për komunikim të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë me nxënësit e moshave të ndryshme, shkathtësi të zhvilluara organizative për vendosjen dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme me nxënësit. Ai duhet të jetë kreativ, i përgjegjshëm, demokratik dhe inventiv, t'i nxitë, inkurajojë dhe mbështetë të gjithë nxënësit. Në këtë mënyrë, arsimtari i ndihmon nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit dhe ua tregojnë rrugën se si të mësojnë. Arsimtari duhet të jetë i shkathët në vlerësimin, mbikëqyrjen dhe shënimin e përparimit të nxënësve, duke përdorur metodat kualitative, siç janë portofoli i nxënësve dhe raportet interaktive për grupin pozitiv, duhet t'i njohë mirë shkathtësitë sociale dhe individuale të të mësuarit për nxënësit të caktuar, që të mund të ndjekë dhe t'i plotësojë nevojat e të gjithë nxënësve, pa marrë parasysh organizimin e mësimdhënies në klasë.



Gjithsesi, arsimtarët duhet të kenë para së gjithash qëndrim pozitiv për punën në paralele të kombinuara.

2.2. Formimi i paraleles së kombinuar

Në përputhje me normativën ligjore dhe njohuritë shkencore, është më mirë që paralelja e kombinuar të formohet në mënyrë të tillë që në të të përfshihen nxënës të klasave që vijnë njëra pas tjetrës (për shembull, nga klasa e parë dhe e dytë, nga klasa e katërt dhe e pestë, nga klasa e gjashtë dhe e shtatë etj.). Gjithashtu, paralelja ku përfshihen nxënës nga klasa që i përkasin të njëjtës periudhë (për shembull, nga klasa e parë, e dytë dhe e tretë; klasa e parë dhe e tretë; ose nga klasa e shtatë, tetë dhe nëntë; klasa e shtatë dhe e nëntë etj.). Në këtë mënyrë krijohen kushte për zhvillimin e kompetencave të nevojshme të nxënësve.

Drejtorët dhe arsimtarët, në bazë të përvojës së tyre në punën me paralelet e kombinuara, mund të përfshijnë në ato paralele nxënës, në varësi nga numri i nxënësve dhe specifikat e paraleleve. Formimi i paraleleve të kombinuara të nxënësve nga klasa e parë dhe e pestë, kur ka edhe nxënës nga paralele të tjera, nuk është adekuat, sepse ekziston dallim i madh në moshë dhe në karakteristikat zhvillimore midis nxënësve, kurse nga ana tjetër, nuk ka asnjë bazë ligjore për këtë. Me përjashtim, mund të formohet paralele e kombinuar me nxënës midis të cilëve ekziston dallim më i madh në moshë, vetëm nëse në shkollë ka një numër jashtëzakonisht të vogël të nxënësve.

Gjatë formimit të paraleleve të kombinuara duhet të merren parasysh këto dy aspekte:

- **formal-normativ** – gjatë formimit të paraleles së kombinuar të respektohen dispozitat ligjore të Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161 më 05.08.2019);
- **pedagogjik-metodik** – gjatë formimi të paraleleve të kombinuara udhëheqësia e shkollës duhet të ketë kujdes për periudhat zhvillimore dhe numrin e nxënësve, për shkak të respektimit të zhvillimit psikik-fizik të nxënësve, ndikimin më të madh të nxënësve të klasave më të larta mbi nxënësit e tjerë; sigurimi i kushteve të nevojshme hapësinore dhe kushteve të tjera të nevojshme për realizimin e mësimdhënies në të njëjtën periudhë zhvillimore.



3. ORGANIZIMI I HAPËSIRËS/KLASËS NË PARALELEN E KOMBINUAR

Rëndësi të veçantë në realizimin e mësimdhënies në paralele të kombinuar ka organizimi i hapësirës së klasës. Prandaj, duhet të sigurohen kushte të mira për realizimin e mësimdhënies. Sipas Burk Uollsh (Burke Walsh, 2004, f. 120), “arsimtari duhet të jetë arkitekti i hapësirës dhe kohës, duke ndërtuar struktura dhe procedura të qarta për nxënësit, dhe të organizojë një hapësirë të lirë dhe të pavarur, ku fëmijët do ta kenë krejtësisht të qartë se çfarë pritet prej tyre.”³ Hapësira duhet të jetë e organizuar në mënyrë fleksibile, që të mundësojë lëvizje të lirë të nxënësve dhe të shfrytëzohet për aktivitete të ndryshme (punë me grupe të vogla, çifte nxënësish, por edhe për aktivitetet e përbashkëta të të gjithë paraleles). Hapësira ku nxënësit kalojnë shumë orë në ditë, së pari duhet të jetë interesante dhe e këndshme. Nuk rekomandohet të organizohet klasë tradicionale me rreshta me banka, por hapësira të ndahet në më tepër pjesë dhe zona. Para së gjithash, duhet të mundësohet që vendosja e karrigeve të jetë fleksibile dhe të mundësojë kushtet e nevojshme hapësinore për punë efikase të arsimtarit. Nëse arsimtari planifikon më tepër punë në grupe/ diskutim në grup do të lërë pak hapësirë për punë individuale.

Klasa e organizuar mirë për paralelen e kombinuar duhet të:

- - jetë e gjerë dhe e rregulluar;
- të ketë kënde për punë në grupe ose qendra për të mësuar;
- të ketë hapësirë që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur;
- të jetë e pajisur me tabela (dy tabela) mjete audio-vizuale dhe multimediale;
- të ketë materiale didaktike, ndihmëse dhe pune;
- të jetë e pajisur me mobile për renditjen e diferencuar të materialeve;
- të ketë pano muri, hapësirë për ekspozitë;
- të ketë byro për arsimtarin;
- të ketë mobilie për detyra të ndryshme të nxënësve;
- të ketë orar të aktiviteteve gjatë ditës (orar ditor)

³ Burke Walsh, K. (2004). Kurikulum za prvi razred osnovne škole Stvaranje razreda usmjerenog na dijete. Zagreb: Udruga roditelja Korak po korak.



Fotografia 1-5:
Shembull për organizimin
e hapësirës në SHKT "Strasho
Pinxhur", fsh. (Konjare e
Poshtme), shkolla rajonale
në Kadino Sello

- të ketë dollapë individuale për çdo nxënës;
- të ketë orë muri, që nevojitet për të shfrytëzuar në mënyrë racionale kohën gjatë punës me nxënësit e çdo klase;
- të jetë e pajisur me bibliotekë, në dispozicion të çdo nxënësi, e pajisur me literaturë shkencore dhe beletristikë, enciklopedi për fëmijë, fjalorë, botime për lexime jashtë klase, revista dhe të tjera, që nxënësit do t'i përdorin gjatë punës së pavarur etj.

Arsimtari, në bashkëpunim me nxënësit duhet të përcaktojë rregulla me të cilat do të rregullohet puna dhe sjellja e nxënësve në paralele, me qëllim që:

- nxënësit të mund të gjejnë dhe ruajnë mjetet, gjërat, materialet, materialet e pastrukturuara etj.;
- nxënësit të mund të ulen në mënyra të ndryshme për aktivitete të ndryshme;
- nxënësve t'u mundësohet hapësirë për zgjidhje individuale të ushtrimeve/përmbushjen e detyrave;
- nxënësit të mund të kërkojnë ndihmë gjatë të mësuarit – si, kur dhe prej kujt (përveç se prej arsimtarit) etj.

Këto rregulla e lehtësojnë punën e arsimtarit, kurse në këtë mënyrë anashkalohet konfuzioni dhe shfrytëzohet më me efikasitet koha në klasë.

Klasa duhet të jetë e pajisur për realizimin e mësimdhënies bashkëkohore dhe, gjithsesi, të jetë në përputhje me Normativin për hapësirë dhe pajisje.



Në çdo rast, të gjitha materialet e punës dhe të gjitha burimet e të mësuarit duhet të jenë në dispozicion të nxënësve. Fondet dhe materialet duhet t'i nxitin nxënësit të jenë aktivë dhe të shprehen lirisht, ta kënaqin kureshtjen e tyre dhe të jenë në përputhje me nevojat e nxënësve që të konstruktojnë dhe rikonstruktojnë, d.m.th. të jenë në gjendje t'i përdorin ato për veprimtari individuale dhe për aktivitetet në grupe, t'i motivojnë nxënësit për operacione intelektuale që i karakterizojnë format më të zhvilluara të të menduarit logjik ose matematikor dhe ofrojnë mënyra të ndryshme të përdorimit, kështu që nxënësit të jenë në gjendje të gjejnë vazhdimisht mënyra të reja për përdorimin e tyre etj.

Kompjuteri ka një rëndësi të madhe në paralelet e kombinuara. Me përdorimin e kompjuterëve, krijohen kushte të mira për respektimin e dallimeve midis nxënësve, për maksimizimin e zhvillimit të shkathtësive të tyre, për përparim në përputhje me zhvillimin dhe interesat individuale. Arsimitari, mbi të gjitha, është organizator i punës, këshilltar dhe bashkëpunëtor, moderator dhe ndërmjetës. Paralelja e kombinuar duhet të organizohet si një mjedis stimulues për zhvillimin e pavarësisë dhe kreativitet të nxënësve, t'i aftësojë nxënësit për vetarsimim, kurse përdorimi i kompjuterit duhet të japë një kontribut edhe më të madh në atë drejtim.

Përpunë efikase në paralelet e kombinuara, si dhe në paralelet që janë homogjene në përbërje, është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme të sigurohet një klimë pozitive social-emocionale në klasë, në mënyrë që ajo të jetë miqësore, e sigurt, e rehatshme dhe stimuluese. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të ndërtohet një marrëdhënie pozitive reciproke ndërmjet nxënësve dhe arsimtarit. Komunikimi midis arsimtarit dhe nxënësve është gjithmonë një proces aktiv, në të cilin rol të rëndësishëm kanë respektimi i ndërsjellë, mirëkuptimi, sinqeriteti dhe gatishmëria për të ndihmuar atë që ka nevojë.



4. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA

Planifikimi i mësimit në paralelet e kombinuara është një proces i rëndësishëm dhe kërkon punë profesionale nga arsimtari. Si pikë fillestare për planifikimin e suksesshëm të procesit mësues, është e domosdoshme të keni njohuri të mira të planeve mësimore dhe të programit mësues/programeve mësimore për klasat që janë përfshirë në paralelen e kombinuar. Arsimtari duhet t'u përmbahet qëllimeve të programeve mësimore, d.m.th. rezultateve të nxënies. Rezultatet e nxënies janë baza për planifikimin e punës së arsimtarit. Arsimtari i zgjedh format, metodat e mësimit, teknikat dhe strategjitë, resurset, mjetet mësimore dhe instrumentet më të përshtatshme organizative për monitorimin, ndjekje dhe vlerësimin.

Me planifikim real dhe në kohë të punës mësimore, mësuesi i eliminon situatat problematike në mësimit, improvizimet e ndryshme, aktivitetet e papërshtatshme dhe të pakoordinuara, të cilat (nëse ka) do të kontribuonin që mësimi të jetë joefektiv dhe pa efekt.

4.1. Llojet e planifikimit në paralelen e kombinuar

Planifikimi i mësimit sipas lëndëve mësimore përfshin:

- Planifikim vjetor (Global);
- Planifikim afatmesëm (Tematik), dhe
- Planifikim ditor.

Në fillim të vitit shkollor, arsimtari duhet të përgatisë një plan vjetor për të gjitha lëndët për klasat që përbëjnë paralelen e kombinuar. Planifikimi vjetor është një kornizë për ndarjen e përgjithshme të temave dhe përmbajtjeve, si dhe për planifikimin e parë tematik. Planifikimi afatmesëm zhvillohet pak para fillimit të realizimit të objektivave/rezultateve të nxënies për secilën temë të re/tjetër. Gjatë vitit, sipas rrethanave të krijuara ose sipas nevojave, arsimtari mund të bëjë ndryshime në planifikimin fillestar të temave. Arsimtari mund ta zgjasë ose ta shkurtojë kohën e parashikuar për realizimin e një teme ose



qëllimi të caktuar, nëse vëren se nxënësit kanë vështirësi në adoptim ose se po përparojnë më shpejt. Në këtë mënyrë, arsimtari planifikon procesin e mësimdhënies dhe të mësimin në bazë të përparimit të nxënësve dhe të vështirësive me të cilat është përballur në periudhat e mëparshme, duke u përqendruar në arritjet e rezultateve nga të mësuarit.

Shënim: Modele për planifikimin vjetor, planifikimin afatmesëm ose tematik dhe për planifikimin ditor, përkatësisht planifikimin e orës së mësimin, janë dhëni si propozime në shtojcën e këtij udhëzimi.

4.4.1. Planifikimi vjetor

Përveç programeve arsimore, arsimtari duhet t'i njohë nxënësit dhe karakteristikat e tyre zhvillimore, mundësitë, interesat dhe aftësitë, kushtet e punës si dhe resurset në dispozicion (librin shkollor që e ka zgjedhur për lëndën konkrete mësimore për klasën konkrete, por që është i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për secilën nga klasat që e përbëjnë paralelen, librat, librat me ilustrime, enciklopeditë dhe burimet e tjera të të mësuarit). Kur arsimtari vlerëson se teksti shkollor dhe manuali nuk ndihmojnë sa duhet për të arritur rezultatet e të mësuarit, të përcaktuara në programin mësimor, ai e plotëson këtë mangësi duke përdorur dhe rekomanduar burime të tjera që do të shërbejnë si burime mësimore.

Planifikimi vjetor është sintetik, arsimtari e planifikon mësimdhënien për lëndët e mësimdhënies për arsimtarët e ciklit të ulët (klasa e parë deri në klasën e pestë), përkatësisht lënda mësimore dhe temat / fushat e programit në kuadër të lëndës mësimore për të gjithë vitin shkollor.



Tabela1: Model për planifikimin vjetor në paralelen e kombinuar

Lënda mësimore				
Tema/fusha dhe numri i orëve	Klasa I	Klasa III	Klasa V	Klasa —
Qëllimet/Rezultatet nga të mësuarit				
Tema/ fusha	Klasa	Klasa	Klasa	Klasa
Qëllimet/Rezultatet nga të mësuarit				
Tema/ fusha	Klasa	Klasa	Klasa	Klasa
Qëllimet/Rezultatet nga të mësuarit				
SHËNIME për:				
Bashkëpunimi me prindërit/mentorët				
Format organizative dhe metodat e mësimdhënies				
Nevoja për diferencim dhe individualizim				

Formati i planifikimit vjetor për paralelen e kombinuar i përmban këto pjesë:

- **Tema/fusha:** Në këtë rresht vendosen temat e programeve mësimore të lëndës konkrete mësimore. Kjo pjesë mund të jetë e njëjtë për të gjitha klasat sepse programet janë spirale, përkatësisht temat në mënyrë të zhvilluar realizohen në të gjitha klasat.



- **Qëllimet/Rezultatet e të mësuarit:** Në këtë pjesë vendosen qëllimet e përgjithshme, përkatësisht rezultatet nga mësimi për një temë konkrete.
- **Klasa:** për çdo klasë do të vendosen aq kolona sa ka klasa që e përbëjnë paralelen e kombinuar.
- **Shënim:** Ky format i planifikimit vjetor është adekuat për paralelen e cila është e kombinuar nga 2 ose më shumë klasa. Nëse arsimtari ka nevojë për më tepër kolona, ai e zgjeron tabelën me kolona të reja.
- **Bashkëpunimi me prindërit/mentorët/Format organizative dhe metodat e mësimdhënies/Nevoja e diferencimit dhe individualizimit** – hapësirë për vendosjen e përgjithshme të formave bazë për bashkëpunim me prindërit/mentorët (për shembull, mbledhje me prindërit, takime individuale me prind/mentor etj.), cilat forma dhe metoda organizative do të përdoren më shpesh në mësimdhënie gjatë vitit, me theks të veçantë mbi metodat hulumtuese, metodat e lojës etj. dhe puna mësimore në grupe, puna mësimore në çifte, si dhe puna mësimore individuale. Nëse nevojitet përpunimi i POI-t për çdo nxënës në paralele, kjo vendoset në pjesën Qasje e diferencuar dhe e individualizuar në punën me paralele të kombinuara.

4.1.2. Planifikimi afatmesëm/tematik

Planifikimi tematik për paralelet e kombinuara duhet të jetë i veçantë për çdo klasë. Arsimtari duhet të ketë liri dhe fleksibilitet gjatë planifikimit të përmbajtjeve, me qëllim që të mundësojë proces efikas gjatë të mësuarit dhe mësimit, i përshtatur me nevojat e nxënësve.

Për dallim nga planifikimi vjetor, planifikimi afatmesëm përgatitet për një periudhë më të shkurtër dhe mundëson planifikim më të detajuar të mësimdhënies. Ky lloj planifikimi nënkupton se arsimtari i përcakton me kujdes rezultatet e të mësuarit që janë thelbësore në suazat e temës që përpunohet dhe të cilat do të arrihen në një periudhë të caktuar, orët e mësimit (koha e mësimdhënies) brenda së cilës do të arrihen këto rezultate, strategjitë e të mësuarit nëpërmjet të cilave do të lehtësohet arritja e rezultateve të të mësuarit, burimet e të mësuarit, metodat dhe teknikat mësimore në mësimdhënie dhe metodat, teknikat dhe instrumentet e ndryshme për ndjekjen, vlerësimin dhe notimin e arritjeve të nxënësve.

Planifikimi afatmesëm është analitik dhe i specifikon rezultatet e të mësuarit, aktivitetet që duhet të realizohen ose qëllimet që duhen arritur. Arsimtari



e përgatit planifikimin afatmesëm para fillimit të periudhës përkatëse dhe ia paraqet në kohë udhëheqjes së shkollës. Gjithsesi, planifikimi afatmesëm zhvillohet në përputhje me planin mësimor dhe programin mësimor dhe buron nga planifikimi vjetor / global. Nëse ka nevojë për përgatitje të POI-t për ndonjë nxënës në paralele, kjo shprehet në seksionin Qasja e diferencuar ose e individualizuar në punën me paralele të kombinuara

Tabela 2: Model nga planifikimi afatmesëm/tematik

Lënda mësimore:

Periudha:

Orët mësimore:

Klasa:			Klasa:	
Rezultatet nga mësimi i temës:			Rezultatet nga mësimi i temës:	
Tema			Tema	
Numri rendor 1.	Përmbajtja	Aktiviteti	Përmbajtja	Aktiviteti
	Forma, metoda dhe qasja (qasje e diferencuar) në punë Klasa Klasa			
	Vlerësimi Klasa Klasa			
	Mjetet mësimore (burime) Klasa Klasa			

Planifikimi afatmesëm i mësimdhënies në paralelen e kombinuar me dy klasa për një temë i përmban këto elemente:

- **Klasa:** Ka aq kolona sa ka edhe klasa në paralelen e kombinuar.
- **Rezultatet nga mësimi i temës:** Në këtë pjesë vendosen rezultatet e të nxënësve që nxënësi do t'i arrijë nëpërmjet realizimit të temave për secilën klasë. Arsimtari përzgjedh rezultatet e të mësuarit që duhet të arrihen sipas programit mësimor. Për shembull, për lëndën Matematikë (për secilën klasë,



për orët e para), të parapara për temën Numrat / Numërimi, arsimtari do të zgjedhë rezultatet e të mësuarit që kanë të bëjnë me numërimin.

- **Temat:** Në këtë pjesë vendosen temat në përputhje me planin për çdo klasë nga lënda mësimore përkatëse.
- **Numri rendor:** Shkruhen numrat e përmbajtjeve të temave. Numri i përgjithshëm në planin për temat duhet të përputhet me numrin e orëve mësimore të vendosura në planin vjetor.
- **Përmbajtja:** Në këtë pjesë vendosen të gjitha përmbajtjet e temës së planifikuar që do të realizohen gjatë një periudhe të caktuar. Përveç përmbajtjes, arsimtari planifikon edhe orë mësimore për përpunim të projekteve, përsëritje etj. Propozohet, gjithashtu, që të planifikohen edhe orë për diskutim dhe vlerësim të përmbajtjeve të portofolit, në varësi nga koha në dispozicion të arsimtarit për secilën temë. Arsimtari në një paralele të kombinuar duhet të planifikojë për të gjitha klasat që përbëjnë paralelen e kombinuar, duhet të parashikojë integrimin e përmbajtjeve dhe të krijojë mundësi për aktivitete të integruara dhe të veçanta për të gjithë nxënësit. Për shembull, në të njëjtën ditë mësimore, arsimtari planifikon që në një klasë të realizojë përmbajtjen mësimore *Mbledhja dhe zbritja e dy numrave dyshifrorë* (Matematikë), ndërsa në klasën tjetër arsimtari planifikon të përpilojë përmbajtje të përshtatshme mësimore në suazat e operacioneve matematikore mbledhje dhe zbritje.
- **Aktivitete:** Në këtë pjesë vendosen aktivitetet të cilat arsimtari planifikon t'i realizojë. Aktiviteti nënkupton përvetësim të njohurive dhe zhvillim të shkathtësive nëpërmjet situatës praktike ose reale.
- **Metodat dhe format e punës:** Në këtë pjesë, arsimtari i përcakton format organizative, teknikat dhe metodat e mësimdhënies (jo shumë hollësisht, sepse ato do të planifikohen më në detaje në planifikimin ditor)
- **Vlerësimi:** Në këtë pjesë vendosen metodat dhe instrumentet për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në secilën klasë (vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësimi i aktivizimit gjatë diskutimeve në klasë; vlerësimi i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësimi; mbikëqyrje me listë kontrolli me indikatorë; portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, veprimtaria e projektit, etj.) Kjo pjesë është sqaruar më në detaje në planifikimin ditor.
- **Mjetet mësimore/Burimet:** Në këtë pjesë arsimtari i përcakton burimet që do të përdoren për të arritur rezultatet e të mësuarit për secilën klasë



(tekste shkollore, mjete mësimore, fletore pune, përmbajtje digjitale, libra të ndryshëm, libra me ilustrime, revista për fëmijë, enciklopedi, audio dhe video-regjistrime, materiale natyrore, etj.). Kjo pjesë nuk plotësohet detajisht, sepse do të shpjegohet më hollësisht në planifikimin ditor..

4.1.3. Planifikimi ditor/ Planifikimi i orës së mësimt

Plani operativ mund të planifikohet si një planifikim ditor për një temë të përbashkët ditore, por gjithashtu mund të planifikohet për secilën orë veç e veç. Kur planifikohet një orë mësimi, ajo mund të planifikohet për të gjitha klasat. Në rastin e parë, arsimtari i planifikon aktivitetet e përbashkëta me të gjitha klasat që përbëjnë paralelen e kombinuar. Madje edhe kur ka tema të ndryshme, rekomandohet që të planifikohen aktivitete të përbashkëta gjatë orës së mësimt. Për shembull, nëse ora e mësimt ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe aftësive që lidhen me stinën e vjeshtës, nxënësit në njërin klasë mund të vizatojnë motive vjeshte, ndërsa nxënësit në klasën tjetër mund të mësojnë për kohën dhe ndryshimet në natyrë që ndodhin në vjeshtë.



Tabela 3: Model për planifikim ditor/Planifikim i një ore mësimi

Lënda mësimore	Klasa
Tema/Fusha programore	Njësia mësimore
Mjetet mësimore /Burimet	Nocionet kyçe
Mjetet mësimore /Burimet	Lidhja me temat e tjera ose me lëndët e tjera
Artikulimi i orës Pjesa hyrëse: Pjesa kryesore: Pjesa përmbyllëse: Reflektimi:	
Diferencimi	
Vlerësimi	
Detyra shtëpie Klasa Klasa	

- **Lënda mësimore:** Titulli i lëndës mësimore.
- **Klasa:** Vendoset klasa (të gjitha klasat).
- **Tema/Fusha programore:** Vendoset tema/fusha programore nga programi mësimor nga i cili arrihen rezultatet e të mësuarit (për çdo klasë).
- **Njësia mësimore:** Vendoset përmbajtja mësimore. Nëse arsimtari planifikon të njëjtën përmbajtje mësimore për të gjitha klasat, ai e vendos të njëjtën për të gjitha, ndërsa nëse planifikon përmbajtje të ndryshme mësimore shkruhen veç e veç për çdo klasë.
- **Rezultatet nga mësimi:** Në këtë pjesë vendosen rezultatet nga mësimi për çdo klasë.



- ◉ **Nocionet kyçe:** Shkruhen nocionet kyçe që duhet të përvetësohen në këtë orë nga nxënësit e çdo klase.
- ◉ **Mjetet mësimore/burimet për të mësuar:** Shkruhen saktësisht të gjitha mjetet dhe materialet mësimore që duhet të përdoren gjatë orës (për çdo klasë).
- ◉ **Lidhja me temat e tjera dhe me lëndët e tjera mësimore,** nëse ekzistojnë.
- ◉ **Artikulimi i orës së mësimi:** Për çdo fazë të mësimi vendosen teknikat dhe metodat e punës, aktivitetet që janë të veçanta për çdo klasë, si edhe aktivitetet e përbashkëta për të gjithë paralelen.
- ◉ **Diferencimi:** përshkruhet qasja e diferencuar që arsimtari planifikon për nxënësit e paraleleve të ndryshme dhe me mundësi dhe shkathtësi të ndryshme.
- ◉ **Vlerësimi:** Jepen metodat, teknikat dhe instrumentet për ndjekje, vlerësim dhe notim të përparimit të nxënësve.
- ◉ **Detyra shtëpie:** Detyrat e planifikuara të shtëpisë, nëse janë dhënë, në përputhje me Udhëzimin për dhënien e detyrave të shtëpisë, i përpiluar nga Byroja për Zhvillim të Arsimit.



5. ORGANIZIMI I MËSIMDHËNIES NË PARALELET E KOMBINUARA

5.1. Forma organizative të punës në paralelet e kombinuara

● Puna mësimore në çifte

Kjo është një formë e punës mësimore që organizohet shpesh në paralelet e kombinuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për çifte nxënësish të moshave të ndryshme. Dy nxënës, të drejtuar nga njëri-tjetri, komunikojnë dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë, nxënësi më i madh mund t'i shpjegojë nxënësit më të vogël, ta drejtojë të gjejë mënyrën se si ta zgjidhë situatën problemore, etj., kurse duke i shpjeguar dhe duke i dhënë shembuj, në të njëjtën kohë qartëson disa gjëra që nuk janë të qarta sa duhet për të dhe merr njohuri afatgjata.

● Puna mësimore në grupe

Kjo formë, puna mësimore në grupe, organizohet kur tre ose më shumë nxënës duhet të kryejnë një detyrë së bashku me një qëllim të përbashkët, kurse detyrat që u jepen nxënësve mund të ndahen sipas rolit të nxënësit në grup, si dhe sipas fazave në të cilat duhet të zgjidhet detyra e përbashkët (për shembull, hartimi i një projekti, analiza e teksteve të përbashkëta, hartimi i një gazete të përbashkët shkollore, libri, stripi, etj.).

● Puna mësimore individuale

Arsimtari mund t'i caktojë një detyrë një nxënësi, por duhet të dakordohet me nxënësin se si të punojë, kurse nxënësi me mbështetjen e arsimtarit të planifikojë dhe të kryejë punën.

Pas zgjidhjes së pavarur të detyrave, arsimtari duhet të kontrollojë se çfarë kanë bërë nxënësit dhe më pas të vlerësojnë së bashku detyrën e kryer.

● Puna e përbashkët

Edhe pse në paralelen e kombinuar janë përfshi nxënës nga dy apo më shumë klasa, fëmijë të moshave të ndryshme dhe me paranjohuri të ndryshme, megjithatë kjo është e vetmja paralele dhe në të mësimdhënia kryhet në



një klasë të përbashkët, nxënësit dëgjojnë njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë përshtypje, qëndrime dhe mendime. Prandaj, është e natyrshme që në paralelen e tillë dhe në pjesët e mëvetësishme të orës së mësimit të përdoren etapa në punën e përbashkët, kurse kjo më shpesh është pjesa e hyrjes dhe e përfundimit të orës së mësimit. Arsimtari mund të vendosë para të gjithë paraleles ndonjë problem interesant prej të cilit do të dalin detyra të ndryshme për çdo klasë, kurse në fund të orës të gjithë do ta dëgjojnë me kënaqësi se çfarë ka punuar çdo klasë. Për shembull, nxënësit e klasave të ndryshme mund të dëgjojnë ndonjë përrallë, të shikojnë ndonjë film, fotografi, animacion, kurse t'u jepen detyra të diferencuara të cilat duhet t'i kryejnë.

Puna e përbashkët planifikohet detajisht në planifikimin ditor/planifikimin e orës së mësimit. Kështu, për shembull, të gjithë nxënësit dëgjojnë raportin e grupit i cili ka vizituar postën, kurse pastaj nxënësit e klasës së parë kanë ushtrim me gojë "Bisedë telefonike", nxënësit e klasës së dytë e përvetësojnë shkronjën "S", nxënësit e klasës së tretë përvetësojnë njohuri për postën, nxënësit e klasës së katërt punojnë me të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në postë (numri i abonentëve, numri i abonentëve në internet, numri i letrave të cilat i shpërndan postieri në javë etj.), kurse nxënësit e klasës së pestë mund t'i përsëritin shkurtimisht njohuritë të cilat i kanë marrë gjatë orës së mësimit..

5.2. Strategjitë didaktike për punë në grupe të vogla nxënësish me mosha të ndryshme zhvillimore

Për punën në paralelet e kombinuara rekomandohen këto strategji didaktike:

- Mësim aktiv
- Mësim duke zgjedhur probleme dhe me hulumtim (mësimi problemor)
- Mësimdhënie korelative-integruese ose e integruar
- Mësim nëpërmjet projekteve
- Lojëra dhe simulime



● Mësimi aktiv

Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, duke përdorur metoda aktive, nxënësit i arrijnë qëllimet arsimore. Kështu, nxënësit fitojnë njohuri nëpërmjet përvojës, sepse marrin pjesë në planifikimin dhe organizimin e procesit mësimor.

Gjatë mësimit aktiv, imagjinata dhe aftësitë krijuese të nxënësve aktivizohen, dhe ata marrin përgjegjësinë për vendimet në procesin e të mësuarit. Ky është një mësim inovativ për të ardhmen - nxënësit vendosin hipoteza, parashikojnë, simulojnë, propozojnë strategji të ndryshme (për shembull, stuhi idesh, metoda 6-3-5, etj.).

Metoda dhe teknika për një mësimdhënie aktive të suksesshme⁴

Tabela 4: Metoda dhe teknika për mësimdhënie të suksesshme aktive

Metoda/Teknika ¹	Përshkrimi
Stuhi idesh („Brainstorming“)	Individi ose grupi ka mundësinë që të paraqesë idetë e veta mbi një temë apo problem të caktuar. Gjatë kësaj merren parasysh parimet e mëposhtme: sasia është në favor të cilësisë, gjithçka që na ka rënë ndër mend është e mirë, sa më “e çmendur” është ideja aq më mirë është, kombinim dhe zhvillim idesh.
Tryeza e rrumbullakët	Në suaza të një grupi më të vogël ose më të madh, çdo nxënës i thekson, në formë gojore ose me shkrim (në një fletë të përbashkët) idetë e veta, si dhe propozimet e partnerit të vet.
Studimi i rastit	Në bazë të një situatë reale nga jeta, grupi kryen analizë, kërkon zgjidhje, zgjidh probleme dhe përjetësohet me rastin.
Debati	Nxënësve ose grupeve u jepen pozicione të ndryshme për ndonjë temë polemike. Pas një kohe të caktuar, e nevojshme për përgatitje, palët kundërshtarë i theksojnë argumentet e tyre.

⁴ Tomevska-Ilievska, E. (2016), interaktivni modeli za razvivanje na pedagogshkrite kompetencii: Shkup: Fakulteti Filozofik (47).

⁵ Adaptuar nga D. Breneselović-Pavlović, T. Pavlovski (2000), f. 120-125, përkthim: E. Tomevska-Ilievska..



Demonstrimi	Nxënësve u tregohet ose udhëzohen se si të kryejnë ndonjë veprimtari. Demonstrimi zakonisht ndiqet nga mundësia që nxënësit të provojnë ose të bëjnë diçka.
“Udhëtime”	Nxënësit dalin nga hapësira për mësimdhënie jashtë me një detyrë të caktuar: të mbikëqyrin diçka, të gjejnë ose të mbledhin informacione etj.
Panel-diskutim	Të gjithë nxënësit i theksojnë qëndrimet e veta për një temë të caktuar, diskutojnë mbi problemet dhe u përgjigjen pyetjeve.
Grupe diskutimi	Në suazat e grupeve më të vogla, nxënësit diskutojnë për çështje të caktuara dhe arrijnë marrëveshje dhe zgjidhje të përbashkëta. Pastaj e informojnë të gjithë grupin mbi punën e vet, më pas vijon krahasimi dhe diskutimi.
Përpilimi i hartave, grafikëve, matricave	Idetë, vendimet, procedurat dhe operacionet kryesore shënohen, analizohen dhe vendoset lidhja midis tyre.
Projekti	Nxënësit bëjnë projekt ku zbatojnë procedura të caktuara, parime, shkathtësi, njohuri ose qëndrime. Projektet mund të prezantohen gjatë punëtorisë ose të jenë “detyrë shtëpie”.
Kuize/Teste	Mund të përdoren mënyra të ndryshme, para dhe pas mësimit, si mjet për evaluim, si metodë për kontroll të asaj që është mësuar, si lojë etj.
Dramatizim	Nxënësit e ndjekin “përrallën” që e luajnë nxënësit e tjerë sipas një skenari të dhënë. Pastaj, i gjithë grupi diskuton, analizon dhe zgjidh një situatë të caktuar. Grupet e vogla para të gjithëve e luajnë rolin e dhënë sipas skenarit të njëjtë ose të ndryshëm.
Tregimi	Nxënësit tregojnë shembuj konkretë të cilët janë në lidhje me temën që përpunohet... Varianti: lexim i tregimit nga literatura apo rrëfim “ngjarje nga jeta” që është në lidhje me temën.
Ditari	Nxënësit mbajnë ditar në të cilin regjistrojnë mendimet e tyre në lidhje me një temë, problem apo detyrë të caktuar para se të fillojë diskutimi. Kjo teknikë i ndihmon nxënësit të kenë mbikëqyrje në procesin e tyre të të menduarit, kështu që me besim më të madh në vetvete, mund të përfshihen më me siguri në diskutim ose ndonjë formë tjetër të të mësuarit.



Analiza	Nxënësit në mënyrë individuale ose në grupe, analizojnë materiale të caktuara (video-xhirim, tekst, përrallë), duke zbatuar strategji, teknika ose metoda të reja.
Sparing-partner	Vendosja e raportit të mentorimit midis dy nxënësve të cilët takohen gjatë mësimit, që të mund t'i theksojnë së bashku problemet. pyetjet, t'i japin njëri-tjetrit sugjerime, këshilla dhe drejtime.
Informim	Nxënësit informojnë mbi aktivitetet në grup ose mbi punën individuale, që orientohen drejt zgjidhjes së disa problemeve, detyrave etj.
Pyetësor	Nxënësit mbushin pyetësorë, shkallë për vlerësim apo teste me të cilat marrin informacione mbi përparimin e vet në kontekst me temën që përpunohet.
Shqyrtim i materialeve	Nxënësit, individualisht ose në grup i lexojnë materialet që u janë dhënë gjatë mësimit ose ato që nevojiten për mësimit.
Plan aksional	Nxënësit, individualisht ose në grup bëjnë plan për zbatim të qëllimeve të identifikuar të mësuara, aktiviteteve, resurseve dhe kufizimeve kohore.
Fantazi e drejtuar	Nxënësve në një atmosferë të relaksuar u thuhet të përfytyrojnë ndonjë situatë nëpër të cilën i udhëheq arsimtari. Pastaj nxënësit shkëmbejnë çfarë kanë parë, përjetuar apo ndjerë.
Asocimi	Nxënësit nëpërmjet fjalëve, figurave, lëvizjeve apo ndonjë mjeti tjetër i thonë asociet e veta për një temë, shprehje apo nocion të dhënë.
Mentorimi	Nxënësi bëhet çift me një nxënës tjetër i cili ka më shumë përvojë, njohuri dhe shkathësi në lidhje me problemin e dhënë.

● Mësimi me zgjidhje të problemeve dhe me hulumtim (mësimi problemor)

Kjo mënyrë e të mësuarit është mësim me zbulim dhe hulumtim. Arsimtari i ndihmon nxënësit në perceptimin, shpjegimin dhe zgjidhjen e problemeve, duke theksuar veprimtarinë e pavarur të nxënësit. Gjatë zgjidhjes së problemeve, përkatësisht situatës problemore, arsimtari duhet t'i orientojë nxënësit se së pari duhet të këshillohen me bashkënxënësit e tyre ose të kërkojnë ndihmë prej tyre, dhe vetëm pas kësaj të kërkojnë ndihmë ose udhëzime nga arsimtari.



Gjatë mësimit me zbulim dhe hulumtim zhvillohet mendimi krijues, bashkëpunimi, kurioziteti të nxënësit etj. Detyra hulumtuese duhet të ndahet në disa detyra më të vogla, të cilat duhet të zgjidhen në grupe prej tre ose katër nxënësish.

● **Mësimdhënia korelative-integruese ose e integruar**

Arsimtari insiston të lidhë dhe integrojë përmbajtje me fushat e programit/ temat mësimore/tërësitë mësimore dhe të parashikojë aktivitete të veçanta analoge me to. Ideja për korrelacion dhe integrim mund të realizohet me planifikim të projekteve të përbashkëta të cilat mund të jenë me kohëzgjatje prej një dite deri në disa javë.

● **Mësimi nëpërmjet projekteve**

Roli i arsimtarit në këtë lloj pune në grupe është të jetë organizator, bashkëpunëtor dhe mbështetës dhe jo ligjërues. Detyra e përbashkët mund të realizohet gjatë një dite, një jave apo për një periudhë më të gjatë (p.sh. kalendari i kohës). Në qendër të projektit është ndonjë çështje, problem etj.

Rezultatet e punës së përbashkët shpesh janë në formë të përpunimit praktik, gazeta e shkollës, pllakat muri etj., kurse pas përfundimit të detyrës duhet të rezultojë me produkt të punuar bashkërisht.

Shembull për mësimin nëpërmjet projekteve është përpilimi i gazetës shkollore (marrëveshje për detyrë të përbashkët – projekt, përzgjedhja e emrit të gazetës shkollore, shkrimi dhe ilustrimi i artikujve, krijimi i ballinës, ide sipërmarrëse (për shembull, si dhe ku do të shitet), planifikimi i mënyrës së promovimit solemn të gazetës. Këtu nxënësit më të mëdhenj u ndihmojnë më të vegjëlve.

● **Loja dhe simulime**

Metoda e lojës përdoret shumë shpesh në punën me nxënësit e moshës më të vogël. Arsimtari mund të organizojë lloje të ndryshme lojërash, si për shembull: lojëra për gara, lojëra për bashkëpunim, kombinim të lojërave për gara dhe lojërave për bashkëpunim, simulime të disa situatave (loja me role për situata konkrete etj.), krijim i situatave.

Është e rëndësishme të përmendet se para se të fillojë puna në grupe më të vogla duhet të përcaktohen me patjetër rregullat e sjelljes së nxënësve (me dakordim të përbashkët).

Pas përfundimit të orës së mësimit arsimtari, duhet të kërkojë nga nxënësit të mendojnë mbi aktivitetet e orës dhe t'i vlerësojnë me fjalë, me teknikën "semafor" ose me numra, me qëllim që tek ata të zhvillohet aftësia për kritikë dhe vetëkritikë.



5.3. Llojet e orëve mësimore në paralelet e kombinuara

Në varësi se çfarë do të përpunohet me përmbajtjen e re mësimore apo do të sistematizohen njohuritë e nxënësve në çdo klasë më vete, orët e mësimin në paralelet e kombinuara mund të klasifikohen në shumë lloje.

● Puna në paralelen e kombinuar të përbërë nga dy klasa:

- Orë mësimi ku njëra klasë përvetëson njohuri të reja, kurse nxënësit e klasës tjetër i përcaktojnë, përsëritin apo i zgjerojnë njohuritë e veta;
- Orë mësimi ku në të dy klasat nxënësit mësojnë njohuri të reja;
- Orë mësimi ku nxënësit e të dy klasave i përcaktojnë, përsëritin ose zgjerojnë dijet e veta.

● Puna në paralelen e kombinuar të përbërë nga tri klasa:

- Orë mësimi për përvetësim të njohurive të reja në të tri klasat;
- Orë mësimi ku nxënësit e të tri klasave i përcaktojnë, përsëritin ose zgjerojnë dijet e veta;
- Orë mësimi ku nxënësit në dy klasa përvetësojnë dije të reja, kurse në klasën e tretë nxënësit i përcaktojnë, përsëritin ose zgjerojnë dijet e veta;
- Orë mësimi ku nxënësit e dy klasave i përcaktojnë, përsëritin ose zgjerojnë dijet e veta, kurse në një klasë nxënësit përvetësojnë dije të reja.

Në paralelet e kombinuara me dy klasa, mësimdhënia mund të planifikohet, organizohet dhe realizohet lehtë, por një sfidë e vërtetë, edhe për mësuesit më me përvojë, është planifikimi, organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies në klasa të kombinuara me tri ose më shumë klasa. Specifikat e punës në klasat e kombinuara me tri ose katër klasë imponojnë nevojën për të planifikuar dhe zbatuar orë mësimi në të cilat do të përvetësohen njohuritë e reja në një ose dy klasa, kurse në dy klasat e tjera nxënësit do të përcaktojnë, përsërisin ose zgjerojnë njohuritë e tyre. Orët e tilla të mësimin janë më racionale dhe i mbingarkojnë më pak edhe arsimtarët edhe nxënësit.



5.4. Organizimi i orës sipas orarit të lëndëve mësimore

Organizimi dhe realizimi i orëve në paralelet e kombinuara, nga aspekti i orarit të orëve të mësimit, është gjithashtu, një detyrë e koklavitur për arsimtarin.

- Arsimtari, realizon një orë mësimi nga një lëndë në të gjitha klasat. Për shembull, në të gjitha klasat, mësuesi mund të realizojë orën e mësimit të Arsimtari Fizik dhe Shëndetësor, Arsimtari Muzikor, Arsimtari Figurativ, Orë me bashkësinë e klasës (“Shkathtësitë jetësore”), Matematikës, kurse ndonjëherë edhe lëndë të tjera, nëse kjo është e mundur nga aspekti i spirales së lëndëve mësimore. Në këto orë, do të zbatohet në maksimum qasja e diferencuar në punë, në varësi nga ndryshimi në karakteristikat zhvillimore të nxënësve që janë përfshirë në paralelet e kombinuara.
- Arsimtari i arrin qëllimet e mësimdhënies dhe realizon përmbajtjet mësimore nga lëndë të ndryshme gjatë një ore mësimi, një orë në një klasë, kurse me klasat e tjera, kur ai nuk është i pranishëm drejtpërdrejt, realizon mësimin duke organizuar punë të pavarur. Arsimtari duhet të kontrollojë çdo punë të pavarur të nxënësve, d.m.th. ta komentojë atë, dhe mbi këtë bazë nxënësit duhet të vazhdojnë me punën. Arsimtari duhet të planifikojë mirë kohën për punë të pavarur të nxënësve, në mënyrë që të përshatet me kohëzgjatjen e një ore mësimi. Ekzistojnë dy variante të kësaj mënyre të të punuarit:

Variante i parë paraqitet përkohësisht, kur nxënësit e një klase zgjidhin testim, detyrë me shkrim, zgjidhin ushtrime, punojnë fletë kontrolluese etj., kurse arsimtari për këtë kohë punon drejtpërdrejt me klasën tjetër, kurse këtë e bën gjatë gjithë orës së mësimit.

Variante i dytë është i shpeshtë dhe rekomandohet, sepse arsimtari atëherë është i pranishëm në të gjitha klasat. Nuk ka rrezik që mësimi të jetë vetëm për programin e një apo dy klasave dhe sigurohet realizim i programit mësimor në të gjitha klasat. Me këtë mënyrë punë mund të realizohen me vështirësi hyrja dhe përfundimi i orëve të mësimit. Mangësia e këtij variante është se nuk i shfrytëzon sa duhet mundësitë e punës së përbashkët në klasë.

Shënim: Në mësimdhënien në paralelet e kombinuara duhet të ketë fleksibilitet të madh në lidhje me organizimin e kohës, me rekomandim për tejkallim të sistemit klasor-lëndor. Kjo çështje duhet të diskutohet me këshilltarët dhe inspektorët.



Shibli sugjeron që në paralelet e kombinuara të krijohen kushte që nxënësit të mësojnë para mësimdhënies, gjatë mësimdhënies dhe pas mësimdhënies⁶. Për shembull, në paralelen e kombinuar me nxënës të klasës së shtatë deri në klasën e nëntë, arsimtari mund të përgatisë përmbajtje për nivel më të ulët (për shembull në PowerPoint), nxënësit ta lexojnë para se të vijnë në klasë dhe pas ardhjes në orë të plotësojnë një pyetësor të shkurtër duke i shfrytëzuar të dhënat nga PowerPoint. Procesi “të mësuarit para mësimi” mundëson që të fitohet kohë që të mund të angazhohen nxënësit në aktivitetet, diskutimet dhe punën në grupe dhe në këtë mënyrë të arrihen njohuritë dhe shkathtësitë e niveleve më të larta të taksonomisë së Blumit. Autorët sugjerojnë që pas përfundimit të mësimdhënies arsimtarët t’u japin nxënësve ushtrime më të përbëra.

Në kombinimet me shumë klasa, arsimtari duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë organizimit të mirë të kohës, dizajnit dhe gjetjes së resurseve dhe mjeteve të nevojshme për të mësuar, me qëllim që të sigurojë përvetësim cilësor të përmbajtjeve mësimore, artikulum të mirë të orës dhe të përzgjedhë me kujdes format sociale të punës. .

⁶ [16] Shibley, Ike. 2009. 10 Ways to Improve Blended Learning Course Design. In Magna Publications Online Seminar, edited by B. Snyder.



5.5. Orari i orëve të mësimi në paralelet e kombinuara

Një nga supozimet themelore për organizim të suksesshëm të mësimdhënies në paralelet e kombinuara është përpilimi i orarit funksional të orëve të mësimi.

Puna në paralelet e kombinuara, realizohet, gjithashtu, pa anashkalime të planeve dhe programeve mësimore, në aspektin e përfaqësimit të lëndëve mësimore sipas klasave dhe orëve mësimore të parashikuara në nivel javor dhe vjetor.

Gjatë përpilimit të orarit të orëve të mësimi, arsimtari duhet të ketë parasysh kërkesat didaktike, si dhe specifikat e punës në paralelet e kombinuara.

Orari i orëve të mësimi duhet të jetë në përputhje me këto kërkesa:

- Në paralelet e kombinuara orari i mësimve duhet të jetë simetrik në raport me renditjen kohore të lëndëve mësimore gjatë javës së punës për çdo klasë më vete.
- Nëse për disa lëndë janë planifikuar më shumë orë mësimore në javë sesa ditët e punës (gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe, gjuha boshnjake), në ditët kur duhen planifikuar dy orë nga këto lëndë, duhet të insistojmë që ato të mos jenë njëra pas tjetrës, d.m.th të mos organizohet i ashtuquajtur i bllok-orë, sepse karakteristikat zhvillimore të këtyre nxënësve nuk mundësojnë vëmendje dhe përqendrim maksimal. Bllok-orë mund të planifikohen vetëm kur ekzistojnë kushte dhe mundësi për bllok orë, për shembull, bllok-orë për Arsim figurativ, ose kur orët mësimore parashikohen për shprehje gojore dhe me shkrim të nxënësve në suazat e gjuhëve amtare. Në raste të tjera, rekomandohet që midis dy orëve të së njëjtës lënde mësimore, në një ditë, të planifikohet një orë mësimi nga një lëndë tjetër. Gjithashtu, nuk rekomandohen bllok-orë për lëndën e Arsimit Fizik dhe Shëndetësor.

Arsimtari duhet të ketë parasysh kur nxënësit më të vegjël kanë lëndë mësimi të cilat japin mundësi për punë të pavarur (për shembull Arsimi figurativ) ose në ato ditë kur nxënësit më të vegjël kanë më pak orë, atëherë për nxënësit e klasave më të larta të planifikojë orë mësimi ku do të ketë më shumë mësimdhënie të drejtpërdrejtë.

Si përvojë e suksesshme në përpilimin e orarit të orëve në paralelet e kombinuara mund të rekomandohet orari i orëve për një ditë mësimore prej gjashtë orësh. Me këtë formë organizimi të mësimi të kombinuar, klasat e ciklit të ulët vijjnë në



dy orët e para të mësimit kur arsimtari i realizon me ta dy orët e para të mësimit (Gjuhë Amtare dhe Matematikë), klasat e ciklit më të lartë vijnë nga ora e tretë dhe i realizojnë së bashku orën e tretë dhe të katërt. Pas orës së katërt, nxënësit e klasave më të ulëta përfundojnë, kështu që orën e pestë dhe të gjashtë arsimtari realizon orët për Gjuhë Amtare dhe Matematikë me nxënësit e klasave më të larta. Kështu lëndët Gjuhë Amtare dhe Matematikë realizohen veç e veç, kurse lëndët e tjera realizohen së bashku.

● **Përparësitë e kësaj forme të organizimit të mësimit në kombinuar janë:**

- nxënësve u jepet mundësi të ndjekin orët e Gjuhës Amtare dhe Matematikës në një paralele të vogël, përkatësisht numër i vogël i nxënësve dhe
- i mundëson arsimtarit ta ndjekë më mirë procesin e të nxënësve.

● **Mangësitë e kësaj forme të organizimit janë këto:**

- krijon lodhje dhe mbingarkesë të arsimtarit;
- nuk mundëson që nxënësit të mësojnë së bashku dhe nga njëri-tjetri në të gjitha orët e mësimit;
- E zvogëlon zhvillimin e shkathtësive sociale të nxënësve; dhe
- nuk krijon shumë mundësi që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.

Në përputhje me Ligjin për arsimin fillor, duhet të organizohet përfshirje e nxënësve nga klasa e parë deri në të tretën një orë para fillimit të mësimit dhe këtë periudhë të ditës arsimtari mund ta shfrytëzojë për realizim të aktiviteteve specifike të planifikuara vetëm për një numër nxënësish.

Orari i orëve në paralelen e kombinuar duhet të jetë fleksibil, përkatësisht të përshtatet. Arsimtari duhet të vendosë të gjitha lëndët mësimore për çdo klasë të paraleles së kombinuar për çdo ditë, por nuk duhet ta vendosë me patjetër edhe rendin e tyre (arsimtari e përcakton rendin gjatë përgatitjes së mësimit). Orarin e përcakton në përputhje me lidhjen e përmbajtjes, mundësinë për punë të pavarur të nxënësve, si dhe në varësi nga fakti se a përpunohet përmbajtje e re mësimore apo përsëritet materiali.



5.6. Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni në paralelet e kombinuara

Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni mbahen në përputhje me Rregulloren për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik dhe evidencës në shkollën fillore⁷ dhe është e obligueshme për të gjitha shkollat fillore, kurse përbëhet nga: libri kryesor i nxënësve; ditari i paraleles, lista evidentuese e suksesit të nxënësve/nxënëseve, legjitimacioni i nxënësit, shtesa e dëftesës, evidenca pedagogjike për aktivitete jashtëshkollore, evidencën pedagogjike për mësim shtesë dhe evidenca pedagogjike për mësim plotësues. Këto lloje të evidencës pedagogjike dhe dokumentacione mbahen edhe në paralelet e kombinuara. Ditari i paraleles plotësohet në përputhje me Rregulloren për mbajtjen e ditarit të paraleles.


⁷ Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik dhe evidencës në shkollën nëntëvjeçare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 28; 07.02.2020)



Literatura:

1. BurkeWalsh, K. (2004). Kurikulum za prvi razred osnovne škole:Stvaranje razreda usmjerenog na dijete. Zagreb: Udruga roditelja Korak po korak.
2. Gardner, H. (2005). Disciplinarnium: Obrazovanje kakvo zaslužuje svako dijete: S one strane činjenica i standardiziranih testova. Zagreb: Educa.
3. Glasser, W. (1994). Kvalitetna škola. Zagreb: Educa.
4. Ligji për arsimin themelor “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.161 05.08.2019).
5. Jensen, E. (2003). Super-nastava: Nastavne strategije za kvalitetnu školu i uspješno učenje. Zagreb: Educa.
6. Lataille-Démoré, D. (2005). Guide documenté des pratiques réussies. Projet des classes à niveaux multiples. CD-ROM. Ontario Ministry of Education. 21. Veenman, S., Kenter, B. etPost.
7. Lučić, K., Matijević, M. (2004). Nastava u kombiniranim odjelima. Zagreb: Školska knjiga.
8. Matijević, M., Topolovčan, T. (2017). Multimedijaska didaktika. Zagreb: Školska knjiga.
9. Maus, D., Reynolds, D. (2017). Mësimdhënia efektive: hulumtime dhe praktika. (Përktheu: Emilija Veljanova), Shkup: Ars Lamina.
10. Stankovic, M, Gorgevik, D, Organizacija nastave u kombinovanim odeljenjima, Decje novine, Gornji Milanovac,1981.
11. Tomevska-Ilievska, E. (2017), Qasje interaktive në mësimdhënie. Shkup: Fakulteti Filozofik.
12. Tomevska-Ilievska, E., E. (2016), Modele interaktive për zhvillimin e kompetencave pedagogjike: Mjet ndihmës mësimor. Shkup: Fakulteti Filozofik.
13. https://www.academia.edu/3648689/596960_Rad_u_koimbiranim_razrednim_odjelima_1_
14. Practicaltipsforteachingmultigradeclases, Corporateauthor: UNESCO Office BangkokandRegionalBureauforEducationinAsiaandthePacific [809], ISBN: 978-92-9223-453-9 (electronic).
15. <https://pdfs.semanticscholar.org/d776/46fc5f444e1c058d79d31890cf795d45fedc.pdf>Effectiveness of Multi-GradeClasses: CooperativeLearningas a KeyElementofSuccessParvinKadivar, ShokoohNavabiNejad, andZahraMadadiEmamzade.

SHTOJCA





Shtojca nr.1

Lloji dhe numri i paraleleve të kombinuara në mësimin klasor në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin shkollor 2018/2019

Lloje të paraleleve të kombinuara në mësimin klasor	Shkup	Kumanovë, Likovë, Staro, Nagoričan, Kriva Palankë, dhe Kratovë	Veles, Čashka dhe Gradsko	Shtip, Karbinci, Lozovo, Sveti Nikole, Radovish, Konçe dhe Probitip	Kočani, Zërnovce dhe Vinicë	Berovë dhe Peçevë	Dellçevë dhe Makedonska Kamenicë	Kavadarci, Rosoman, Negotinë, Demir Kapi, Gjevgeji, Bogdanci dhe Dojran	Strumicë, Novo Selië, Vasilevo, Bosillovë dhe Vallandovë	Manastir, Mogillë, Resnjë dhe Demir Hisar	Prilep, Krivogashtan, Dollneni, Krushevë, Makedonski Brod	Tetovë, Bogovinë, Bërvenicë, Jegunovcë, Tearcë dhe Zhelinë	Gostivar, Mavrovë-Rostushë dhe Vrapçisht	Dibër dhe Qendër Zhupë	Kërçovë	Strugë dhe Veçvan	Ohër	Numri i përgjithshëm p (sipas kombimit)
1 dhe 2	7	5		3	1	1	1	3	3	2	6	8	4		2	1	1	48
1 dhe 3	4	1		4			1	2	5	5	7	1	3	1	2	1	2	39
1 dhe 4	2		1	1	1			1	3	2	3	1	2			1		18
1 dhe 5	4	1						1	7	2	2	2	2			2		23
2 dhe 3	7	8	1	8	6	3	6	2	8	4	2	7	1		1	2	2	68
2 dhe 4	8	10	1	5	3			5	12	15	5	10	6	1	1	4		86
2 dhe 5	2	1		1	1			1	5	8	2	1	1		2	1		26
3 dhe 4	7	1		1	1	1		1	6	1	1	2	4		2	1	2	31
3 dhe 5	4	7	3	5	1			5	5	10	6	12				4	2	64
4 dhe 5	10	12	9	21	7	7	6	7	7	6	17	15	4	2	6	3	10	149
1, 2 dhe 3	4	4	5	9	1	3		5	3	4	9	4	2	3	3		6	65
1, 2 dhe 4	1							2	1	1	1	1	2		1			10
1, 2, 5				1	1				1				3					6
2, 3 dhe 4	4	1	1	1					2		1	2						12
2, 3 dhe 5								1	1	2	3	1	1			1		10
3, 4 dhe 5	1	3	1							1	1	1	2				1	11
1, 2, 3 dhe 4	2	4		2					1	2	1		3	2			1	18
1, 2, 3 dhe 5	1	2		1				1		1	4							10
1, 2, 3, 4 dhe 5	4	4	2	3			1		3	15	11	1	1		1	1	1	48
1, 4 dhe 5	1																	1
1, 3 dhe 5	4	3						3	2	10	3	2	3					30
1, 3 dhe 4	2			1				2		4				1				10
2, 3, 4 dhe 5		3	3	1				3		7	2	1			1	1		22
2, 4 dhe 5		1						2		5	1	1				1		11
1, 3, 4 dhe 5			1	1					1	1	2		2					8
1, 4 dhe 5				1	1				1	4	1							8
1, 2, 4 dhe 5				1	1			1	1	5	2							11
Gjithsej	79	71	28	71	25	15	15	48	78	117	93	73	46	10	21	25	28	843



Shtojca nr. 2

Lloji dhe numri i paraleleve të kombinuara në mësimin lëndor në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin shkollor 2018/2019

Lloje të paraleleve të kombinuara në mësimin lëndor	Shkup	Kumanovë, Likovë, Staro Nagorican, Kriva Pallanikë dhe Kratovë	Veles, Çashka dhe Gradsko	Shtip, Karbinci, Liozovo, Sveti Nikole, Radovish, Koççe dhe Probištip	Kočani, Zërnovce dhe Vitiçë	Berovë dhe Pehçevë	Dellçevë dhe Makedonska Kamenicë	Kavadarci, Rosoman, Negotinë, Demir Kapi, Gjergjeli, Bogdanci dhe Dojran	Strumicë, Nevo Sellë, Vasilevo, Bosillovë dhe Vallandovë	Manastir, Mogiljë, Resnjë dhe Demir Hisar	Prilep, Krivogashtan, Dolneni, Krushevë, Makedonski Brod	Tetovë, Bogovinë, Bërvenicë, Jegunovcë, Tearcë dhe Zhelinë	Gostivar, Mavrovë-Rostushë, dhe Vrapçisht	Dibër dhe Qndër Zhupë	Kërçovë	Strugë dhe Veçpan	Ohër	Numri i përgjithshëm (sipas llojit të kombinimit)
6 dhe 7	12	3		1	1			1			3	2	2		1			26
6 dhe 8	2	1											1			1	1	6
6 dhe 9																		0
7 dhe 8		1																1
7 dhe 9	1				1								1			1	1	5
8 dhe 9	12	3		1	1			1			3	2	1					24
6, 7 dhe 8	1																	1
6, 7 dhe 9	1																	1
6, 7, 8 dhe 9	1	1																2
3, 4 dhe 6									1									1
Gjithsej	30	9	0	2	3	0	0	2	1	0	6	4	5	0	1	2	2	67



Shtojca nr. 3

Numri i shkollave nëntëvjeçare, objekti dhe gjuha në të cilën realizohet mësimi në paralelet e kombinuara

Në **Qytetin e Shkupit** ka 27 shkolla nëntëvjeçare me 49 objekte në të cilat mësimi organizohet në 121 paralele të kombinuara. Në 49 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 63 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, në 7 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke dhe në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën serbe. Mësimi i kombinuar realizohet në shkolla në komunat në vijim:

- **Karposh** – në 1 shkollë nëntëvjeçare me 1 ndërtesë ka 1 paralele të kombinuar në të cilën mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Saraj** – në 5 shkolla nëntëvjeçare me 6 objekte ka gjithsej 15 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 13 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Çuçer-Sandevë** – në 2 shkolla nëntëvjeçare me 5 objekte ka gjithsej 16 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 3 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 11 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën serbe.
- **Gazi Babë** – në 2 shkolla nëntëvjeçare me 2 objekte ka gjithsej 4 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- **Haraçinë** – në 1 shkollë nëntëvjeçare me 2 objekte ka gjithsej 3 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 1 paralele të kombinuar mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 2 klasa paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Butel** – në 1 shkollë nëntëvjeçare me 1 ndërtesë ka 1 paralele të kombinuar në të cilën mësimi realizohet në gjuhën maqedonase;
- **Shuto-Orizare** – në 1 shkollë nëntëvjeçare me 1 ndërtesë ka 2 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- **Çair** – në 2 shkolla nëntëvjeçare me 2 objekte ka gjithsej 11 klasa të kombinuara, nga të cilat: në 5 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe



- **Aerodrom** - në 1 shkollë nëntëvjeçare me 1 ndërtesë ka 2 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Kisella Vodë** - në 2 shkolla nëntëvjeçare me 2 objekte ka gjithsej 13 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 11 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Sopishte** - në 1 shkollë nëntëvjeçare me 5 objekte ka gjithsej 13 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 3 paralele të kombinuara realizohet në gjuhën turke.
- **Studeničan** - në 3 shkolla nëntëvjeçare me gjithsej 7 objekte ka gjithsej 20 paralele të kombinuara, nga të cilat: në 1 paralele të kombinuar mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 15 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- **Zelenikovë** - në 1 shkollë nëntëvjeçare me 4 objekte ka gjithsej 7 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- **Ilinden** - në 2 shkolla nëntëvjeçare me 4 objekte ka gjithsej 5 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- **Petrovec** - në 2 shkolla nëntëvjeçare me 6 objekte ka gjithsej 8 paralele të kombinuara në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.

Në rajonet në vijim ka gjithsej 173 shkolla nëntëvjeçare me 521 objekte në të cilat ka 838 paralele të kombinuara. Në 636 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 141 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, në 55 paralele të klasave të kombinuara realizohet në gjuhën turke dhe në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën serbe.

- Në rajonin **Kumanovë, Likovë, Staro Nagoričan, Kriva Pallankë dhe Kratovë** në 16 shkolla nëntëvjeçare me 53 objekte ka gjithsej 81 paralele të kombinuara. Në 60 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 15 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe dhe në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën serbe.
- Në rajonin **Veles, Çashkë dhe Gradsko** në 8 shkolla nëntëvjeçare me 20 objekte ka gjithsej 28 paralele të kombinuara. Në 23 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 5 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.



- Në rajonin **Shtip, Karbincë, Llozovë, Sveti Nikollë, Radovish, Konçe** dhe **Probishtip** në 14 shkolla nëntëvjeçare me 46 objekte ka gjithsej 81 paralele të kombinuara. Në 62 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 19 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Koçan, Zërnovc** dhe **Vinicë** në 10 shkolla nëntëvjeçare me 20 objekte ka gjithsej 31 paralele të kombinuara, kurse mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- Në rajonin **Berovë** dhe **Pehçevë** në 2 shkolla nëntëvjeçare me 9 objekte ka gjithsej 15 paralele të kombinuara, në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- Në rajonin **Dellçevë** dhe Makedonska Kamenicë në 3 shkolla nëntëvjeçare me 10 objekte ka gjithsej 15 paralele të kombinuara, në të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.
- Në rajonin **Kavadarc, Rosoman, Negotinë, Demir Kapi, Gjevgjeli, Bogdanc** dhe **Dojran** në 13 shkolla nëntëvjeçare me 33 objekte ka gjithsej 56 paralele të kombinuara. Në 52 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Strumicë, Novo Sello, Bosillovë** dhe **Vallandovë** në 15 shkolla nëntëvjeçare me 48 objekte ka gjithsej 81 paralele të kombinuara. Në 69 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Manastir, Mogillë, Resnjë** dhe **Demir Hisar** në 19 shkolla nëntëvjeçare me 82 objekte ka gjithsej 117 paralele të kombinuara. Në 96 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 17 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Prilep, Krivogashtan, Dollnen, Krushevë** dhe **Makedonski Brod** në 18 shkolla nëntëvjeçare me 61 objekte ka gjithsej 100 paralele të kombinuara. Në 82 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 18 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- Në rajonin **Tetovë, Bogovinë, Bërvenicë, Jegunovc, Tearcë** dhe **Zhelinë** në 20 shkolla nëntëvjeçare me 41 objekte ka gjithsej 83 paralele të kombinuara. Në 55 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase.



donase, në 24 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe dhe në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.

- Në rajonin **Gostivar, Mavrovë-Rostushë** dhe **Vrapçisht** në 13 shkolla nëntëvjeçare me 36 objekte ka gjithsej 54 paralele të kombinuara. Në 24 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 30 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.
- Në rajonin **Dibër** dhe **Qendër Zhupë** në 2 shkolla nëntëvjeçare me 7 objekte ka gjithsej 10 paralele të kombinuara. Në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase dhe shqipe.
- Në rajonin **Kërçovë** në 8 shkolla nëntëvjeçare me 17 objekte ka gjithsej 23 paralele të kombinuara. Në 6 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 15 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 2 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Strugë** dhe **Vevçan** në 8 shkolla nëntëvjeçare me 19 objekte ka gjithsej 30 paralele të kombinuara. Në 12 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, në 14 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe, kurse në 4 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën turke.
- Në rajonin **Ohër** në 4 shkolla nëntëvjeçare me 19 objekte ka gjithsej 33 paralele të kombinuara. Në 32 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, kurse në 1 paralele të kombinuara mësimi realizohet në gjuhën shqipe.



Shtojca nr. 4

Modeli 1: orari i orëve të mësimit – klasa e parë dhe e dytë (Paralele e kombinuar)

Orë	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
1	I kl. Gjuhë angleze II kl. Gjuhë angleze	Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Matematikë Matematikë	Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Gjuhë amtare
2	I kl. Gjuhë amtare II kl. Gjuhë amtare	Matematikë Matematikë	Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Matematikë Matematikë	Matematikë Matematikë
3	I kl. Matematikë II kl. Matematikë	Shoqëria Arsimi figurativ	Arsimi figurativ Shkencat natyrore	Gjuhë amtare Gjuhë amtare	AFSH AFSH
4	I kl. shkencat natyrore II kl. Ora e bashkësisë së klasës		Shkencat natyrore Arsimi figurativ	Arsimi figurativ Shoqëria	Arsimi muzikor Arsimi muzikor
5	I kl. Arsimi muzikor II kl. Arsimi muzikor	II kl. Mësim plotësues	AFSH AFSH	Gjuhë angleze Gjuhë angleze	Shkencat natyrore
6	II kl. Mësim shtesë				



Modeli 2: Orari i orëve të mësimit – klasa IV dhe V (mësimdhënie e kombinuar)

Orë	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
1	IV kl. Ora e bashkësisë së klasës V kl. Arsimi teknik	Shkencat natyrore Matematikë	Shkencat natyrore Matematikë	Gjuhë amtare Matematikë	Matematikë Shkencat natyrore
2	IV kl. Matematikë V kl. Arsimi teknik	Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Shoqëria	Matematikë Puna me kompjuter dhe bazat e programimit	Arsimi figurativ Matematikë
3	IV kl. Gjuhë maqedonase V kl. Matematikë	Matematikë Shoqëria	Matematikë Gjuhë amtare	Gjuhë angleze Gjuhë angleze	Gjuhë amtare Gjuhë amtare
4	IV kl. Shoqëria V kl. Gjuhë maqedonase.	Shoqëria Arsimi figurativ	Arsimi muzikor Arsimi muzikor	Gjuhë angleze Gjuhë angleze	Arsimi muzikor Arsimi muzikor
5	IV kl. AFSH V kl. AFSH	AFSH AFSH	Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Arsimi figurativ	AFSH AFSH	Arsimi teknik Shkencat natyrore
6	IV kl. Gjuhë angleze V kl. Gjuhë angleze	Mësim plotësues ose shtesë Mësim plotësues ose shtesë	Arsimi figurativ Puna me kompjuter dhe bazat e programimit	Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Gjuhë amtare	Mësim plotësues ose shtesë Mësim plotësues ose shtesë
7				Ora e bashkësisë së klasës	



Modeli 3: orari i orëve të mësimi – klasa I, II, III, IV dhe V (paralele e kombinuar)

Orë	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	
1	kl. I Gjuhë amtare kl. II Ora e bashkësisë së klasës kl. III Ora e bashkësisë së klasës kl. IV Ora e bashkësisë së klasës kl. V Arsimi teknik	Gjuhë amtare Matematikë Gjuhë amtare Shkencat natyrore Matematikë	Gjuhë amtare Matematikë Matematikë Matematikë Shkencat natyrore Matematikë	Matematikë Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare Matematikë	Matematikë Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare Matematikë	Matematikë Gjuhë amtare Arsimi figurativ Matematikë Shkencat natyrore
2	kl. I Matematikë kl. II Gjuhë amtare kl. III Gjuhë amtare kl. IV Matematikë kl. V Arsimi teknik	Matematikë Gjuhë amtare Matematikë Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Matematikë Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare Shoqëria	Gjuhë amtare Matematikë Matematikë Matematikë Puna me kompjuter	Arsimi figurativ Matematikë Matematikë Arsimi figurativ Matematikë	
3	kl. I Shkencat natyrore kl. II Shkencat natyrore kl. III Shkencat natyrore kl. IV Gjuhë amtare kl. V Matematikë	Gjuhë amtare Arsimi figurativ Gjuhë amtare Matematikë Shoqëri	Shkencat natyrore Shkencat natyrore Shkencat natyrore Matematikë Gjuhë amtare	Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze	Gjuhë amtare Shoqëria Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare	
4	I kl. Shoqëria II kl. Matematikë III kl. Matematikë IV kl. Shoqëria V kl. Gjuhë amtare	Arsimi figurativ Gjuhë amtare Arsimi figurativ Shoqëri Arsimi figurativ	Arsimi muzikor Arsimi muzikor Arsimi muzikor Arsimi muzikor Arsimi muzikor	Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze	Arsimi muzikor Arsimi muzikor. Arsimi muzikor. Arsimi muzikor Arsimi muzikor	



5	I kl. AFSH II kl. AFSH III kl. AFSH IV kl. AFSH V kl. AFSH	AFSH AFSH AFSH AFSH AFSH	Arsimi figurativ Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Arsimi figurativ	AFSH AFSH AFSH AFSH	Mësim shtesë ose plotësues Shoqëri Arsimi teknik Shkencat natyrore
6	kl. III Gjuhë angleze kl. IV Gjuhë angleze kl. V Gjuhë angleze	Mësim shtesë ose plotësues Mësim shtesë ose plotësues Mësim shtesë ose plotësues Mësim shtesë ose plotësues	Arsimi figurativ Puna me kompjuter dhe bazat e programimit	Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Puna me kompjuter Puna me kompjuter dhe bazat e programimit Gjuhë amtare	Mësim shtesë ose plotësues Shoqëri Arsimi teknik Shkencat natyrore
7				kl. V Ora e bashkësisë së klasës	



Modeli 4: Orari i orëve të mësimit – klasa e parë, e dytë dhe e tretë (paralele e kombinuar)

Orë	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
1	I kl. Gjuhë amtare II kl. Gjuhë amtare III kl. Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare
2	I kl. Matematikë II kl. Matematikë III kl. Matematikë	Matematikë Matematikë Matematikë	Matematikë Matematikë Matematikë	Matematikë Matematikë Matematikë	Matematikë Matematikë Matematikë
3	Kl. I Arsimi figurativ Kl. II Shoqëri Arsimi figurativ Kl. III Puna me kompjuter dhe bazat e programimit	Shkencat natyrore Shkencat natyrore	Gjuhë amtare Gjuhë amtare Gjuhë amtare	Shkencat natyrore Shkencat natyrore Arsimi figurativ	Shoqëria Shoqëria Shoqëria
4	Kl. I Arsimi muzikor Kl. II Arsimi muzikor Kl. III Arsimi muzikor	AFSH AFSH AFSH	Arsimi muzikor Arsimi muzikor Arsimi muzikor	Arsimi figurativ Arsimi figurativ Arsimi figurativ	.AFSH AFSH AFSH
5	I kl. Gjuhë angleze II kl. Gjuhë angleze III kl. Gjuhë angleze	Mësim shtesë ose plotësues Shkencat natyrore	Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze	AFSH AFSH AFSH	Kl. III Mësim shtesë ose plotësues
6	Kl. I Ora e bashkësisë së klasës		Kl. III Gjuhë angleze	Kl. III Shkencat natyrore	Kl. II Ora e bashkësisë së klasës Kl. III Ora e bashkësisë së klasës



Shtojca nr. 5

Modeli 1: Planifikimi i orës së mësimi

Lënda mësimore Gjuhë maqedonase	Klasa: I dhe II
Tema/Fusha programore Letërsi	Njësia mësimore “Qershia e Stefanit”
Rezultatet nga mësimi Klasa I – nxënësi/nxënësja është i/e aftë të zbulojë elementet e krijimeve letrare (hapësirë, kohë, ngjarje dhe personazhe). Klasa II – nxënësi/nxënësja është i/e aftë të dallojë titullin e tekstit, mund të dallojë tekst, ilustrim dhe autor.	Nocionet kryesore Klasa I – Hapësira e ngjarjes, rrjedha dhe rendi i ngjarjeve, personazheve Klasa II– Titull, ilustrim, autor
Mjetet mësimore/burimet Kompjuter, LCD-projektues, libër digjital me ilustrime “Qershia e Stefanit”, libër me ilustrime i botuar “Qershia e Stefanit”, komplet me fotografi në të cilat tregohet përmbajtja e librit me ilustrime, fletë mësimi.	Lidhja me tema të tjera ose me lëndë të tjera Shkencat natyrore, Arsimi figurativ
Artikulimi i orës	
Hyrja: Nxënësve u rikujtohen pemët e qershisë me lule që i kanë mbikëqyrur më parë. Arsimtari i njeh nxënësit me qëllimet e orës dhe e tregon librin digjital me ilustrime “Qershia e Stefanit”.	
Pjesa kryesore: Klasa I – Pas bisedës së shkurtër për librin, nxënësve u jepet detyrë (në nivel grupi) të bisedojnë se ku ndodhin ngjarjet, kush është personazhi kryesor, kurse kompletin me fotografi ku tregohet përmbajtja e librit i vendosin sipas rendit të ngjarjeve. Arsimtari e ndjek punën e nxënësve në grup dhe e plotëson listën e kontrollit. Klasa II – Çdo nxënësi/nxënësja e shqyrton librin e botuar me ilustrime “Qershia e Stefanit”, pastaj secilit i jepet një fletë mësimore ku duhet të shkruajë, individualisht, titullin e tekstit, sa ilustrime ka libri dhe emrin dhe mbiemrin e autorit. Secilit i jepet detyrë të thotë se cili ilustrim i ka pëlqyer më shumë.	
Përfundimi: Në fund të orës, një nga nxënësit e klasës I do të tregojë se ku ndodhin ngjarjet në këtë tekst, një nxënësi tjetër do të thotë kush është personazhi kryesor në këtë tregim, pastaj çdo nxënësi në grupin e klasës I do të dalë me një fotografi në dorë ku jepet një pjesë e përmbajtjes së librit dhe do ta ngjijtë në vendin përkatës në tabelë, sipas rendit të ngjarjeve. Nxënësit e klasës II lexojnë secili se çfarë kanë shkruar në fletën e vet të mësimi, kurse pastaj secili prej tyre e përshkruan ilustrimin që i pëlqen më shumë. Nxënësit e tjerë duhet të gjejnë se për cilin ilustrim bëhet fjalë. Pas përfundimit të orës, arsimtari kërkon nga nxënësit të mendojnë mbi aktivitetet në orë dhe t’i vlerësojnë me teknikën “semafor”.	
Diferencimi	
Vlerësimi Klasa I – Është përgatitur listë kontrolli me elementet e shkruara (hapësira ku ndodh ngjarja, rrjedha dhe rendi i ngjarjeve, personazhi, emri i çdo nxënësi/nxënësja me hapësirë për shënim). Klasa II – Vlerësimi i fletëve të punës për çdo nxënësi/nxënësja.	
Detyra shtëpie Të gjithë nxënësit duhet të shkruajnë se çfarë u ka pëlqyer më shumë në tekstin e përpunuar.	



Modeli 2: Planifikimi i orës së mësimi

Lënda mësimore Shoqëria	Klasa: I dhe II
Tema/Fusha programore klasa I – Shkolla ime klasa II – Unë me të tjerët	Njësia mësimore Rregullat e sjelljes
Rezultatet nga mësimi Nxënësi/nxënësja merr pjesë në vendosjen dhe zbatimin e rregullave në klasë dhe në shkollë.	Nocione kryesore Klasa I – Rregulla, përgjegjësi Klasa II – Rregulla në klasë
Mjetet mësimore /burimet Letër, lapsa me ngjyra, mjete për të shkruar	Lidhja me tema të tjera ose me lëndë të tjera Arsimi figurativ
Artikulimi i orës Hyrja: Arsimtari bisedon me nxënësit për lojërat e preferuara dhe cilat janë rregullat për këto lojëra. I nxit nxënësit të mendojnë se çfarë rregullash të sjelljes duhet të vendosen në shkollë. Pjesa kryesore : Arsimtari i ndan nxënësit në dy grupe, ku secili grup duhet të ketë nxënës të klasës së parë dhe të dytë. Nxënësit diskutojnë në grupet e veta dhe më pas një nxënës nga secili grup propozon një rregull të sjelljes dhe shpjegon pse e propozon atë. Nxënësit e grupit të dytë dakordohen midis tyre dhe një nxënës thotë a u pëlqen propozimi apo jo (nëse nuk e pranojnë propozimin, ata shpjegojnë pse). Pastaj një nxënës nga grupi i dytë propozon një rregull sjelljeje dhe shpjegon pse e propozon, kurse nxënësit e grupit të parë deklarojnë nëse propozimi është i pranueshëm apo jo. Pasi të vendosin rregullat, nxënësit bien dakord se cili grup do t'i vizitojë rregullat e miratuara. Rregullat i vizitojnë nxënësit e klasës së parë, kurse nxënësit e klasës së dytë i shkruajnë ato. Arsimtari do të monitorojë punën e nxënësve në grupe dhe e shënon veprimtarinë e nxënësve gjatë propozimit të rregullave. Përfundimi: Vizatimet me rregullat e ilustruara të sjelljes, nxënësit i vendosin në një vend të dukshëm. I rikujtojnë edhe njëherë rregullat e sjelljes dhe çfarë mund të ndodhë nëse nuk respektohen rregullat. Në fund të orës, nxjerrin përfundim se të gjithë janë përgjegjës për respektimin e këtyre rregullave. Ata bien dakord që të kujtojnë njëri-tjetrit nëse ndonjë nxënës harron të respektojë ndonjë nga rregullat. Pas përfundimit të orës, arsimtari kërkon nga nxënësit të mendojnë mbi aktivitetet në orë dhe t'i vlerësojnë me teknikën "semafor".	
Vlerësimi Ndjekja e aktiviteteve të nxënësve, vlerësimi i argumenteve për pranim apo refuzim të rregullave të propozuara (te nxënësit e klasës së dytë).	
Diferencimi	
Detyra shtëpie Klasa I – Nxënësit të vizitojnë rregull për sjellje në shtëpitë e tyre. Klasa II – Nxënësit të shkruajnë disa rregulla të sjelljes në shkollë.	

